

## RELACION TEKNIK I PROJEKT ZBATIMIT

### RRUGA SHEQ - GAJDË

#### TË PËRGJITHSHME

Kjo rrugë ndodhet në veri-perëndim të qytetit Ura Vajgurore, në të Djathtë të rrugës nacionale Urë Vajgurore - Tiranë. Rruga ka një gjatësi totale prej 2 275 ml. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor do të lehtësojë në mënyrë të ndjeshme lëvizjen e banorëve të fshatit Sheq - Gajdë.

Asetet bujqësore në këtë zonë janë të shumta por mungesa e infrastrukturës bëhet nje pengesë serioze për të gjetur tregun.

Rritja e fluksit të transportit për prodhimet agrikulturore të banorëve të zonave rurale që administrohen nga Bashkia Dimal, shton detyrimin për një infrastrukturë standarte dhe komode. Veçanërisht kërkohet që rrjeti rrugor të ketë parametrat e duhura dhe të jetë kompatibël me rrjetin rrugor kombëtar në mënyrë që levizja e mallrave apo komunitetit te bëhet në mënyrë të sigurtë dhe në kohë sa më të shkurtër.



## GJENDJA EKZISTUESE

Segmenti rrugor në fshatin Sheq-Gajdë ku do të ndërtohet rruga kalon përmes ndërtimeve 1-2 dhe 3 katëshe në zonën e Njesisë Administrative Poshnje. Pothuajse gjatë të gjithë gjatësisë rruga ka një gjerësi konstante 3 - 5m. Gjendja ekzistuese e trupit të rrugës është në kushte relativisht të këqija, me shtresa rrugore të degraduara, përgjithësisht me një mbulesë çakëlli ose stabilizanti nga mirëmbajtja në mënyrë periodike por që nuk ja jetëgjatësi. Kanalet anësore të rrugës janë mbushur me dhe, kanë nevojë për hapje dhe në disa vende për veshje me beton, gjë e cila bën të mundur drenazhimin e ujërave sipërfaqësor duke ndikuar në mosdëmtimin e trupit të rrugës.

Gjatë hartimit të këtij projekti është menduar që të shfrytëzohet traseja ekzistuese. Kjo rrugë përfaqëson një trase të deformuar, duke mos krijuar mundësinë e drenimit të ujërave sipërfaqësore. Në këtë segment rrugor do të kryhen punime asfaltike, do të ndërtohen kanale të veshur me beton në disa pjesë të rrugës dhe do parashikohen ndërtimi i bankinave në të dy anët e rrugës. Bankinat, do të shërbejnë si distance sigurie mes korsisë së lëvizjes dhe kanaleve anësore. Rruga përgjatë gjithë gjatësisë së saj do ketë pjerrësi tërthore gjë e cila mundëson drenazhimin e ujërave sipërfaqësore direkt aty ku ka kanale anësore ekzistues dhe ato që do parashikohen të ndërtohen.





















## PERSHKRIMI PROJEKTIT

Për hartimin e projektit të kësaj rruge në radhë të parë u inspektua gjendja ekzistuese e rrugës dhe të gjithë elementëve të infrastrukturës që lidhen me rrugën. Rruga në një pjesë të saj është e asfaltuar por shtresat asfaltike janë të dëmtuara dhe në pjesë të caktuara rruga ka çedime. Mungesa e sistemit të ujrave atmosferike është bërë problem për banorët pasi shpesh ndodh që ato të shkarkohen në oborret e banesave apo edhe me tej akoma brenda në banesa, kjo pasi kuota e banesave është më e ulët se ajo e rrugës. Gjatë inspektimit kemi dëgjuar ankesat e banorëve për gjendjen në të cilën ndodhet rruga. Ndërtimi i kësaj rruge do ti japi një zhvillim të rëndësishëm zonës si nga ana shoqerore ashtu edhe nga ana ekonomike.

## HARTIMI I PROJEKT IDESE

Bashkia Dimal ka për qëllim rikonstruksionin e rrugës në përputhje me standartet Europiane për ta kthyer atë në një aks rrugor me tepër funksional. Rruga Sheq - Gajdë duke qenë se paraqet një planimetri të ndryshueshme në gjatësinë e tij do të ketë trajtim të veçantë në secilin prej segmenteve të tij.

Ky segment është nga rruga nacionale Lushnje - Ura Vajguore deri në fshatin Sheq, ka një shtrirje në një formacion të qëndrueshëm në disa pjesë ka çedime të cilat do të trajtohen duke ndërhyrë në nënshtresa sipas detajit tip me 2x20 cm çakëll, 10 cm stabilizant dhe shtresat asfaltike. Ka një gjerësi aktuale që varion nga 4-5 ml. Në disa pjesë ku kemi te bejmë vetëm në shtresat asfaltike ku do të bëhet skarifikim i shtresës ekzistuese asfaltike dhe karikim me 20 cm çakëll, 10 cm stabilizant dhe 7 cm binder.



Segmenti II dytë është rruga kryesore që përshkon fshatin Sheq deri në dalje të fshatit Sheq në mes të zonës së banuar e cila paraqet një gjerësi rruge nga 3 m deri në 5 m. Ndërhyrjet në këtë segment do të jenë nga shtresa asfaltike deri në reabilitimin e nënshtresës në disa pjesë sipas planimetrisë dhe profilave tip për çdo segment do të realizohen dhe kanale anësor.

#### **Punimet që do të kryhen janë :**

**a)** Rikonstruksioni i trupit të rrugës duke përfshirë shtresat rrugore të cilat do të zëvendësohen, kjo do të realizohet duke skarifikuar shtresat ekzistuese deri në trashësinë 30 cm dhe ribërja e tyre me 2 shtresa cakëll me 20 cm, stabilizant 10 cm, binder 7 cm.

Gjerësia e rrugës do të jetë variabël sipas gjerësisë aktuale 4.5 m asfalt dhe dy bankina me stabilizant me gjerësi 50 cm.

Në trupin e rrugës ku do të kemi kasonete të re të behet një shtrese makadam (kalldremi me gur) me trashësi 20 cm. Dy shtresa cakëll me nga 20 cm, stabilizant 10 cm, binder 7 cm. Ngjeshja duhet të realizojë një shtresë kompakte në mënyrë që të mos kemi ulje të ndryshme nga trupi i rrugës ekzistuese.

**b)** Sistemi i ujrave sipërfaqësore do të realizohet duke ndërtuar kanale anësore dhe largimi i ujrave do të bëhet me anë të një rrjeti të hapur. Pika e shkarkimit për ujrë të shiut do të jenë në rrjedhje të lirë jashtë trupit të rrugës.

### **PARAMETRAT TEKNIK TE RRUGES**

**Gjeometria e Rrugës**, pas përpunimit të të dhënave gjeodezike të marra nga rievimi faktik i kryer në terren dhe në konsultim me të dhënat e kërkuara në termat e references rruga duhet të ruaj format ekzistuese në pjesën dërmuese të saj në rrafshin horizontal, sepse kjo formë e propozuar dhe e ekzekutuar në terren. Elementet ndërtimor do të jenë në përputhje dhe harmoni.

**Profili gjatësor**, (Niveleta) duke ju referuar gjendjes ekzistuese të rrugës na rezulton se nuk kemi deformime të mëdha të niveletës të cilat nuk krijojnë disnivele. Për të mos cënuar aksesin e banesave dhe infrastrukturën sekondare që ndërthuret me objektin tonë, propozojmë që kuotat e projektit tonë të jenë të njëjta me ato ekzistuese, pra në këtë mënyrë të gjitha punimet të kryhen poshtë këtij niveli dhe në përfundim shtresat e reja të ngelet i pa ndryshuar në kuotë.

**Format niveluese**, trafiku në trasenë e rrugës do të zhvillohet në një nivel, gjithsej kemi një kalim për automjete.

**Konstruksioni**, për rikonstruksionin e rrugës janë parashikuar 1-2 shtresa cakëll me 20 cm, stabilizant 1x10cm dhe shtresa asfaltike me trashësi 7 cm, kjo për faktin se në këtë aks është i lejueshëm qarkullimi i mjeteve të lehta dhe jo me ngakese, gjithashtu është gjykuar që të shkohet më thellë me shtresat pasi bazamenti i rrugës paraqet dëmtime të cilat do të kërkonin dhe shtresa të tjera si bazë apo nën bazë.

**Seksioni tip i rruges**, duke qenë se planimetria e rrugës tonë paraqet ndryshime dhe nuk është uniforme lind nevoja që të aplikohen seksione tip përkundrejt ndryshimeve planimetrike që paraqiten.

**Siguria dhe sinjalistika rrugore**, meqenese në këtë aks rrugë nuk kemi levizje me intensitet të lartë të automjeteve dhe këmbësorëve dhe shpesh lëvizja e tyre ndërthuret, parashikohet që cilësia e materialeve si horizontale ashtu dhe vertikale të jetë e cilësisë më të lartë. Në të gjitha situatat ku do të kemi



inersektim të kalimeve të tilla si, këmbësore - automjete, do të parashikohen të gjithë elementet sinjalizues të nevojshëm. Gjatë kohës së kryerjes së punimeve të rrugës përveç masave të sigurimit do të merren dhe masat e sigurisë në rrugë duke vendosur sinjalistikën e përkohshme të nevojshme sipas kodit rrugor.

**Shpronësimet**, meqënëse projekti zhvillohet brenda dimensioneve ekzistuese të rrugës pa pasur nevojë për zgjerime apo ndryshime të gjurmës së rrugës nuk kemi nevojë për shpronësime.

**Organizimi i punimeve dhe preventivi**, për ndërtimin e rrugës është parashikuar që materialet e ndërtimit të merren konform specifikimeve teknike dhe provave laboratorike të përcaktuara në specifikimet teknike. Fabrika e prodhimit të asfalteve, betoneve dhe para-fabrikateve të jenë të gjitha larg objektit të ndërtimit duke ruajtur të gjitha kondicionet e përcaktuara në studimin e ndikimit në mjedis. Të gjitha dherat e dala nga gërmimet dhe materialet e tepërta të pa përshtatshme do të parashikohet të transportohen e sistemohen në vende të posaçme të përcaktuara nga institucioni administrues në marrveshje me supervisorin dhe pushtetin lokal. Të gjitha punimet janë parashikuar në përputhje me specifikimet teknike që i bashkëngjiten këtij projekti. Në preventiv do të parashikohen të gjithë zërat e punimeve të këtij projekti me çmimet e manualit mbështetur në Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 15.7.2015 Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre.

Bashkëngjitur këtij raporti do të jenë: Specifikimet teknike të punimeve, volumet e punimeve me vleresimet e kostove (preventivi), volumet metrike të punimeve, raporti i punimeve topo-gjeodezike dhe raporti i vleresimit të mjedisit.

## **6- PERFUNDIME**

Ndërtimi i këtij aksi rrugor është mjaft i rëndësishëm për këto arsye :

- a)** Përmirëson kushtet e lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorëve në këtë aks
- b)** Disiplinon trafikun në përgjithësi në këtë segment
- d)** Implementimi i këtij projekti do të japë një efekt pozitiv financiar në komunitet

- Projekti është hartuar nga Bashkia Dimal nga inxhinierë specialistë të Drejtorisë së Planifikimit në përputhje me standartet për projektimin e rrugëve dhe duke marrë në konsideratë çdo kërkesë dhe propozim të banorëve të zonës.

- Bashkëngjitur këtij relacioni teknik të projekt zbatimit do të jepen materialet grafike të projektit si, planimetria e përgjithshme e rrugës, profilet tërthore dhe profili gjatësor.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT